Shoqerite		Pjesmarrja e Aksioneve	Vlera e kapitalit bashkise Shkoder
<b>Ujësjiellës Shkodër</b>	<b>Kanalizime</b>	100% e aksioneve	863,468,000 lek
<b>Tregu i Shumice Fruta – Perime</b>	<b>Shitjes me</b>	32.78 % të aksioneve	49,500,000 lek.
<b>Parku i Shkodër</b>	<b>Udhëtarëve</b>	60 % të aksioneve	13,944,000 lek.
<b>Klubi i Fubollit “Vllaznia”</b>		100 % e aksioneve	375,322,000 lek

## II. Nxjerrja jashtë përdorimi të aktiveve .

1. Per vitin 2019 eshte kryer procedura e nxjerrjes së perdorimit të aktiveve në Drejtorinë e Arsimit si me poshtë vijon:

1. Nxjerrje jashtë përdorimi i inventarit te imet dhe inventarit ekonomik ne konviktet , shkollat qytet dhe shkollat e njesive administrative



-Nxjerrje jashtë përdorimi dhe asgjësimi i inventarit ekonomik ne konvikte, shkollat e qytetit dhe njesive administrative me vlere 3.346.461 leke dhe me vlerë të akumuluar të amortizimit 428.327 leke dhe inventarit te imet me vlere 6,297.001 leke.

Procedura e nxjerrjes jashtë përdorimi është bërë në zbatim të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit Nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Nxjerrja jashte përdorimi dhe asgjësimi është bërë duke zbatuar në menyre rigoroze të gjitha hapat që përcaktohen ne Udhëzimin Nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik”, i ndryshuar..

Vlerësimi i aktiveve është bërë duke pasur parasysh kriteret e vlerësimit të aktiveve si :

- plotësimi i kohes së shfrytëzimit në bazë të normave të amortizimit
- pamundësinë e riparimit si pasojë e konsumit
- dëmtimi në shkallë të tillë që është e pamundur të kthehen në gjendje pune nëpërmjet riparimit
- kur vlera e riparimit ose e pershtatjes për t’i kthyer në gjendje pune është e barabartë ose më e madhe se vlera e tregut për blerjen e një aktivi të ngjashëm
- kur kanë humbur cilësinë e tyre të caktuara në standartet shtetërore ose në kushtet teknike

Duke pasë parasysh këto kritere grupi i vlerësimit të aktiveve të vlerësuara si jashtë funksioni i ka paraqitur Drejtorit te Drejtorise Arsimit relacionin përkatës të aktiveve të indentifikuara për vlerësim të cilat rezultuan jashtë funksionit dhe janë dërguar në magazinë prane konviktit te shkolles Industriale si mall në ruatje deri në vlerësimin perfundimtar nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi ose i tjetersimit të tyre.Grupi i inventarizimit dhe vleresimit te aktiveve i ngritur me urdherin e brendshem Nr.137 dt.04.12.2019.

Pas marrjes së relacioneve drejtori i institucionit ngriti grupin e nxjerrjes jashtë përdorimi të këtyre aktiveve me urdherin Nr.7/1 dt.03.02.2020 i cili pasi verifikoi në sasi dhe në vlerë aktivet që ishin pasqyruar në procesverbalin dhe relacionin e vlerësimit duke kontrolluar gjendjen e tyre fizike dhe bërë analizen kosto përfitim vendosi që keto materiale nuk mund të përdoren për qellime të tjera dhe dha mendimin qe duhet që të asgjësohen.

Komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit paraqiti proces-verbalin perkates tek drejtori.

Drejtori miratoi asgjësimin e materialeve me Vendimin nr. 43/2 datë 04.02.2020 per konviktet,shkollat e qytetit dhe NJ.A “ Për miratimin e asgjësimit të materialeve të ndryshme te konsumuara të cilat nuk mund të shfrytëzohen për qellime të tjera “.

Komisioni i asgjesimit i ngritur me Urdherin Nr.8/1 dt.05.02.2020 pas marrjes së miratimit të Drejtorit për asgjësimin e materialeve të inventarit mundësoi më parë shkatërrimin e tyre me mjete të përshtatshme për ti bërë ato krejtësisht të gatshme për t’u asgjesuar i cili u krye ne Landfildin Bushat.

2. Per vitin 2019 është kryer Ankand Publik “ Për shitjen e mjeteve të transportit loti i pare (mjete te transportit të dalë jashtë perdorimi për shitje për skrap) sipas VKB nr. 67 , datë 30.10.2017 “Për miratim e shitjes të mjeteve të transportit me procedurë ankandi publik” si me poshtë vijon:

Ankandi i hapur është zhvilluar me datë 10.09.2019 .

Vlera fillestare e ankandit 1,520,540 leke

Vlera fituese e ankandit 1,521,000 leke

Dala e lidhjes se kontrates 11/10/2019

Operatori Ekonomik i shpallur fitues “Çekrezi Metal “

Me date 11.10.2019 nr 2561/46 prot. është lidhur kontrata me firmen fituese.

Kryetarja e Bashkisë ka ngritur urdhërin nr 870 datë 11.10.2019. “ Për ngritjen e grupit të punës për dhënien në dorëzim të mjeteve të trasnportit të dala jashtë përdorimi, të shitura për skrap, shoqërisë fituese Çekrezim Metal, me NIPT K91602003E.

Automjetet e dorezuara nga Bashkia Shkoder ne shoqërisë “Çekrezi Metal jane si me poshtë vijon:

<b>Automjeti</b>	<b>Vendodhja</b>
<b>Makine tip Volvo, ngjyre jeshile ,nr.Shasie YVIVË7113ËF1465875, viti prodhimi 1997</b>	Nd/Ja Ujesjellesit
<b>Kamion tip Magirus 2560, Modeli 19AK, ngjyrë Jeshile, viti prodhimi 1979 , targa SH8083D</b>	Nd/Ja Ujesjellesit
<b>Automjeti makine tip Mercedes Benz 123,Modeli 240D, ngjyrë Bizele, nr.Shasie 12312310136449, viti prodhimi 1980</b>	Nd/Ja Ujesjellesit
<b>Makine tip FAI , Fadrome ngjyrë tullë , vit prodhimi 1977, blere nga ish komuna ne vitin 2005</b>	Nd/Ja Ujesjellesit
<b>Autoveture Mercedes Benz,240, ngjyrë gri ne jeshil , nr. Shasie - , prodhim i vitit 1977</b>	Nd/Ja Ujesjellesit
<b>Kamionin 3.5T Mercedes Benz LPK80E, ngjyrë e bardhë, nr.Shasie 31607214252481, viti prodhimi 1978,Targa SH4127C.</b>	Nd/Ja Ujesjellesit
<b>Automjeti autoveture tip Mitsubishi ONV44 Pajero, ngjyrë e bardhë, nr.Shasie JMBONV440PJ300615, viti prodhimi 1993 Targe SH6208D</b>	Nd/Ja Ujesjellesit
<b>Automjeti makine lloji ATV, marka Dodge, tipi 0, ngjyrë gri, nr.Shasie 2310005799073, viti prodhimi 1978 targa</b>	Nd/Ja Ujesjellesit

<b>AA175 CI ardhur nga Targa SH4252C, date regjistrimi 21.05.2002</b>	
<b>Automjeti lloji Kamion, tip Saurer 2MD, CT5D, ngjyrë jeshile, nr.Shasie 30829, viti prodhimi 1968, Targa SH8771D</b>	Nd/Ja Ujesjellesit
<b>Automjeti lloji motokarro, marka Shifeng, 7YPJZ, 1675P, ngjyrë Blu, nr.Shasie 5050303212, viti prodhimi 2005 Targa SH006C</b>	Nd/Ja Ujesjellesit
<b>Automjeti lloji motokarro, marka Shifeng, 7JPJZ, 1675P, ngjyrë Blu, nr.Shasie 5050303216, viti prodhimi 2005 Targa SH005C</b>	Nd/Ja Ujesjellesit
<b>Automjeti lloji motokarro, marka Shifeng, 7YPJZ, 1675P, ngjyrë Blu, nr.Shasie 5050303210, viti prodhimi 2005 Targa SH008C</b>	Nd/Ja Ujesjellesit
<b>Autobuz Fiat Ruggeri, ngjyrë verdhë , prodhim I vitit 1981-1982, makine e dhuruar</b>	Nd/Ja Ujesjellesit
<b>Automjeti makine pastrimi tip Piaggio ngjyrë Bardhë , nr. Shasie ZAPS8500000562092, prodhim i vitit 2004, pa targa, makine e dhuruar nga Ministria e Rregullimit Territorit dhe Turizmit</b>	Nd/Ja Ujesjellesit
<b>Automjetit autoveture marka Mitsubishi L049 Pajero ngjyrë Vishnje , nr. Shasie JMBLO49GVLJ450350 ,prodhim i vitit1991, targa SH2003E</b>	Nd/Ja Ujesjellesit
<b>Automjeti autoveture marka Toyota,LJ95L Land Cruiser ngjyrë Bardhë, nr. Shasie LJ950003052, prodhim i vitit 1994, targa SH3253E</b>	Nd/Ja Ujesjellesit
<b>Automjeti eshte makine lloji ATP, marka Land Rover, tipi LTD.LP, RANGE ROVER, Nr shasis SALLPAMË8Y444395, ngjyrë jeshile prodhim i vitit 2001, targa SH3434E</b>	Nd/Ja Ujesjellesit
<b>Automjeti Kamion Iveko nr.shasie 003344</b>	Nd/Ja Ujesjellesit
<b>Automjeti autoveture, marka mercedes benz, 124, 250D, ngjyre kafe, nr.shasie ĘDB124151A561215, prodhim i vitit 1987 ,targa SH6920D</b>	Nd/Ja Ujesjellesit
<b>Automjeti makine tip Land Rover, ngjyrë e kuqe ,1974 prodhim i vitit –shasia nr.94901337B me targe TR4638J.</b>	MNZH
<b>Automjeti makine tip Opel, ngjyrë e kuqe , nr.shasie 73045548, targa mungon</b>	MNZH
<b>Automjeti makine tip Chevrolet , ngjyrë e kuqe , nr.shasie - mungon, prodhim i vitit -mungojne të dhënat, targa mungon</b>	MNZH

**Automjeti makine tip Chevrolet, ngjyrë e kuqe , nr.shasie MNZH  
Ë41CTY51589993, prodhim i vitit -mungojne të dhënat,  
targa mungon**

**Eskavator Fadrome caterpillar 4n8 C, APV, LEIBHERR, NJA Dajç  
A902, ngjyrë e verdhë, nr. Shasie 2552768, prodhim i vitit  
1983**

**Autoveture Mercedes Benz, HO, C220, ngjyrë e kuqe, nr. NJA Dajç  
Shasie ËDB2021211A599958, prodhim i vitit 1998, me  
targe SH8950D.**

Fatura totale e peshës skrap ishte **1,236,395 lek** shume e cila eshte paguar nga firma .

Nga totali i listes se mjeteve te transportit të listuara për t'u shituar mungojne

1. mjete Motoçiklete, lloji motore, marka Dayang, tipi DY, Nr shasis LATXCBL571279357 ngjyrë jeshile targa SH226D, prodhim i vitit 2007 nuk ndodhet ne Nd/jen e Ujesjellesit ku eshte lene si mall ne ruatje bashke me te gjithe mjetet e tjera te transportit me flete hyrjen nr 74 date 16.11.2015.

2. Automjeti autoveture marka Toyota, trashëguar nga NJA Shale e cila nuk rezulton si prone e ish Komunes Shale dhe eshte e bllokuar nga policia ( informacion verbal)

Pas informacionit të marrë nga komisioni Nr 19016 prot date 06.11.2019, Kryetarja e Bashkisë ka nxjerre urdherin e çdemtimit Motoçiklete, lloji motore, marka Dayang, tipi DY, Nr shasis LATXCBL571279357 ngjyrë jeshile targa SH226D, prodhim i vitit 2007 në vleren prej 11495 lek .

Vlerë e cila është paguar nga debitori.

3. Per vitin 2019 Bashkia Shkodër ka ne proces të papërfunduar Ankandin e shitjes së mjeteve te transportit me procedurë Ankandi publik si më poshtë vijon:

Kryetarja e Bashkisë me Urdhërin nr 968, datë 11.12.2018 “ Për krijimin e njësisë së ankandit me objekt “ Për shitjen e mjeteve të transportit me procedurë Ankandi publik” ka krijuar njesine e Ankandit publik.

Kryetarja e Bashkisë me Urdhërin nr 86, datë 07.02.2019 “Për ngritjen e komisionit të posaçëm të vleresimit VKB nr 67, datë 30.10.2017 “Për miratim e shitjes të mjeteve të transportit me procedurë ankandi publik” ka ngritur komisionin e vleresimit .

Në zbatim të Urdhërit të kryetarit nr 86, datë 07.02.2019 “Për ngritjen e komisionit të posaçëm të vleresimit VKB nr 67, datë 30.10.2017 “Për miratim e shitjes të mjeteve të transportit me procedurë ankandi publik” dhe Urdhërit të kryetarit nr 968, datë 11.12.2018 “ Për krijimin e njësisë së ankandit me objekt “ Për shitjen e mjeteve të transportit me procedurë Ankandi publik” , Komisioni i Posaçëm i vlerësimit duke u bazuar ne shkresat e Komisionit te Ankandit

ka përcaktuar 7 here vlerën VAM të ankandit për shitje skrap duke ndjekur praktikën si më poshtë vijon:

Komisioni i Posaçëm i Vleresimit, duke iu referuar shkresave të mësipërme dhe VKM nr 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik” ndryshuar me VKM nr.33 date 19.1.2011, VKM nr.692, date 18.10.2011, VKM nr.308 date 10.4.2013 , kreu VI, Kushte të përgjithshme për zbatim, pika 6, Mungesa e konkurrencës, germa “ç”,

*ç)3 Në procedurën e hapur, kur autoriteti shitës nuk ka vendosur asnjë kërkesë të vecantë për kualifikim, sipas procedurave të këtij vendimi, dhe nuk është paraqitur asnjë ofertë për blerje, në vijim të procedurës së parashikuar në shkronjën “c”, të kësaj pike, autoriteti shitës cakton një VAM tjetër 20% më të ulët se VAM-i i përcaktuar në shkronjën “c”, të kësaj pike. Në rast se edhe pas kësaj uljeje, nuk paraqitet asnjë ofertë për blerje, VAM-i ulet deri 20% nga VAM-i i fundit, për cdo shpallje, derisa vlera të arrijë 30% të VAM-it fillestar të ankandit. Përfshihet nga kjo procedurë shitja me ankand e pasurive të paluajtshme.*

Ka përcaktuar çmimin e ankandit VAM vlera aktuale monetare e objektit të shitjes, I cili është si më poshtë:

Lista e mjeteve të transportit, që do të shiten													
Automjeti	Viti i prodhimit	Marka	Modeli	Fuqia motorrike	Lloji i karburantit	Çmimi i ankandit TVSH Vlera Ankand i	1	2	3	4	5	6	7
						Çmimi i ankandit VAM me zbritje 20% lekë pa TVSH për herë të VAM me zbritje 20% lekë pa TVSH për herë të	Çmimi i ankandit VAM me zbritje 20% lekë pa TVSH për herë të	Çmimi i ankandit VAM me zbritje 20% lekë pa TVSH për herë të	Çmimi i ankandit VAM me zbritje 20% lekë pa TVSH për herë të	Çmimi i ankandit VAM me zbritje 20% lekë pa TVSH për herë të	Çmimi i ankandit VAM me zbritje 20% lekë pa TVSH për herë të	Çmimi i ankandit VAM me zbritje 20% lekë pa TVSH për herë të	Çmimi i ankandit VAM me zbritje 20% lekë pa TVSH për herë të
Autovetur e	2001	Daimler Chrysler, 220	S400CDI	3996 cm3	Nafte	500,000	400,000	320,000	256,000	204,800	163,840	150,000	
Autovetur e	1998	Mercedez Benz 210,	E300	2998 cm3	Nafte	400,000	320,000	256,000	204,800	163,840	131,072	120,000	
Autovetur e	2000	Daimler 163	ML 270 CDI,	2685 cm3	Nafte	400,000	320,000	256,000	204,800	163,840	131,072	120,000	

Të ndodhur në kushte, kjo procedurë ankandi është zhvilluar 7 herë për lotin II, III, dhe IV dhe ka dështuar pasi nuk është paraqitur asnjë ofertë, dhe vlera e tyre ka arritur 30% të VAM fillestar, i është propozuar Titullarit të Autoritetit Shites rivlerësimin e mjeteve për vijimin e procedurës për shitjen e tyre.

### III. Detajimi i detyrimeve të palikuiduara në fund të vitit buxhetor 2019

Në fund të vitit 2019 kemi një gjendje detyrimesh në shumën prej **450,462,067** lekë shumë e cila përbëhet nga :

<b>40</b>	Furnitore e llogari te lidhura me to	182,067,262
<b>42</b>	Personeli e llogari te lidhura me to	41,916,291
<b>431</b>	Shteti tatim-taksa	2,745,612
<b>435</b>	Sigurime shoqerore	12,093,452
<b>436</b>	Sigurime shendetsore	1,643,136
<b>467</b>	Kreditore te ndryshem	209,996,314
		<b>450,462,067</b>

Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në vijim të Udhëzimit të posaçëm nr.441, datë 30.12.2019 me nr.24412, datë 30.12.2019 me objekt “ Mbi zbatimin e Buxhetit të vitit 2020”, shkresat nr 21920 prot, date 02.12.2019 me objekt “Mbi prioritetin e pagesave ne kushtet e gjendjes se shpallur te fatkeqesise natyrore” , njoftuar me email zyrtar date 03.12.2019 ora 13.30, shkresa nr.21920/4 prot, date 12.12.2019 me objekt “Mbi shkresen nr 21920 prot, date 02.12.2019”, njoftuar me email zyrtar date 13.12.2019 ora 10, shkresa nr 21920/38 prot, date 20.12.2019 me objekt “Mbi prioritetin e pagesave ne kushtet e gjendjes se shpallur te fatkeqesise natyrore”, njoftuar me email zyrtar date 20 Dhjetor ora 10.40, jemi bllokuar në kryerjen e pagesave, kjo për shkak të situatës së krijuar për gjendjen e shpalljes së fatkeqësisë natyrore.

Sipas përcaktimit në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, detyrime të prapambetura konsiderohen detyrimet financiare të përcaktuara nga një ligj/kontratë /marrëveshje /vendim gjykate i formës së prerë që mbeten të papaguara 60 ditë pas datës së specifikuar në kontratë apo me ligj, duke përfshirë edhe periudhën kontraktuale të shtyrjes së pagesës, të cilat kanë lindur në njësitë e vetëqeverisjes vendore (kontratat e financuara nga qeveria qendrore).

Në zbatim të Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 40, germa “h”, detyrimet e Bashkisë Shkodër janë krijuar në vite, si rrjedhojë e keqmenaxhimit të financave nga ish Komunat (Njësitë Administrative), kjo në zbatim të reformës territoriale VKM nr 510, datë 10.06.2015 “ Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrative-territorial”, si dhe parashikimit optimist të të ardhurave.

Me vendim te Këshillit Bashkiak nr. 15 Dt. 28.04.2016 “Per miratimin e buxhetit faktitk te vitit 2015 te Bashkise Shkoder”, Bashkia Shkoder, ka trashëguar nga ish-komunat

detyrime per vendime gjykate te formes se prere ose ne proces, detyrime me fatura, detyrime pa fatura dhe vetem me kontrata.

Gjate vitit 2019, Bashkia Shkoder, ka raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.5645 prot, datë 08.04.2019, për tremujorin e parë të vitit 2019 dhe me shkresë nr.11359 prot, datë 01.07.2019 për tremujorin e dytë të vitit 2019, dhe me shkresë nr.16578 prot, datë 02.10.2019 për tremujorin e tretë të vitit 2019, si dhe me shkresën nr.1752 prot, datë 28.01.2020 për tremujorin e katërt të vitit 2019.

Në detyrimet e prapambetura peshën më të madhe e zënë Investimet prej rreth **21 milion lekë**, kryesisht me parregullsi ligjore dhe financiare, të pamundura të likuidohen , si dhe shpenzimet gjyqësore prej rreth **28 milion lekë**, në proces gjykimi dhe shpresojmë që këto procese të hapura të jenë në favor të Bashkisë Shkodër.

Me datë 19.03.2019 me nr.4337 prot është bërë shkresë MFE me objekt “Informacion mbi kalendarin e planit të veprimit për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për bashkinë Shkodër për vitet 2019-2022”.

#### **IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET E AUDITIMIT TË BRENDSHËM DHE TË JASHTËM**

##### **IV.1 AUDITI I BRENDSHËM**

Njësia e Auditimit , Bashkia Shkodër , për vitin 2019, ka ushtruar veprimtarinë e saj, bazuar në bazuar në ligjin nr 139/2015 ”Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin 114/2015 “Per Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”: Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2019 “Për miratimin e manualit auditimit brendshëm në sektorin publik”, V.K.M Nr. 83, date 03.02.2019 “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e njësive të auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, planin strategjik dhe vjetor të hartuar në muajin Tetor 2018 për vitin 2019, të miratur nga Titullari i Bashkisë Shkodër. Gjate vitit 2019, auditimet janë përqendruar kryesisht në Bashkinë Shkodër, dhe institucionet Kulturore të vartësisë .

Në auditimet e kryera prane Institucioneve te varesise, janë konstatuar mangësi në planifikimin e punës, në pershkrimin e punës sipas vendeve të punës, në krijimin e hartës proceseve të punës, në plotësimin e regjistrit rriskut, në raportimin në organet eprore të veprimtarisë, në menaxhimin e buxhetit, në administrimin e aseteve, në administrimin e vlerave materiale, në kryerjen e pagesave, kryesisht pagesa per honorare. etj.

Për vitin 2019, misionet e auditimit janë përqendruar kryesisht në Sistemin e Kontrollit të brendshëm, vlerësimit të drejtimit dhe performances. Në sistemin e menaxhimit të buxhetit, ne sistemin e pagesave si dhe në çeshtje te vecanta sipas aktivitetit të Drejtorive të audituara. Në përfundim të procedurave të auditimit janë konstatuar 130 gjetje nga të cilat 21 gjetje ne sistemin e prokurimeve, 4 gjetje ne sistemin e pagesave, 6



gjetje në sistemin e administrimit të pronës, dhe 99 gjetje të tjera të cilat i perkasin sistemit kontrollit brendshëm, drejtimit, performancës, proceseve specifike të punës.

Gjetjet e konstatuara, janë argumentuar me bazë ligjore, si duhej të ishin kryer procedurat e punës, si janë kryer procedurat në fakt, dhe përgjegjësia ligjore sipas rastit.

Për vitin 2019 është konstatuar dëm ekonomik për vlerë 3.546.000 lek e ndarë në 215.000 për llogaritje të gabuar të pagës dhe 3.331.000 lek për pagesa të kryera për honorare.

## **IV .2 AUDITIMI I JASHTËM**

Gjatë vitit 2019 në Bashkinë Shkodër ka ushtruar auditim, Kontrolli i Lartë Shtetit:

- Auditim të Performancës “Zhvillimi i Sherbimeve Sociale per Personat me Aftesi te Kufizuar”.
- Auditim i Performancës “Efektiviteti i menaxhmit dhe administrimit të fondit pyjor dhe kullosor”,
- Auditim të Performancës “Efektivitetin e programeve sociale të strehimit”,
- Auditim me objekt “Mbi auditimin e pasqyrave financiare të institucionit dhe përputhshmërisë e veprimtarisë së subjektit me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu procedurat e prokurimeve me fondet Publike dhe shpenzimet vjetore të Buxhetit”

Me datë 03.01.2019 me shkresë nr.1428/1 , ka ardhur shkresë nga KLSH me objekt Auditim i performancës “Zhvillimi i Sherbimeve Sociale per Personat me Aftesi te Kufizuar”.

Me datë 12.03.2019 me shkresë nr.1426/8 , ka ardhur shkresë nga KLSH me objekt Auditim i performancës “Efektiviteti i menaxhmit dhe administrimit të fondit pyjor dhe kullosor”

Me datë 28.03.2019 me shkresë nr.1423/12 , ka ardhur shkresë nga KLSH me objekt “Auditim të Performancës “Efektivitetin e programeve sociale të strehimit”.

Me datë 31.05.2019, me nr.405 Prot ka ardhur shkresë nga KLSH me objekt auditimi “ Mbi auditimin e pasqyrave financiare të institucionit dhe përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu procedurat e prokurimeve me fondet Publike dhe shpenzimet vjetore të Buxhetit”.

Me datë 08.10.2019 me nr.16123/1 prot, me objekt “ mbi masat paraprake të ndërmarra në zbatim të rekomandimeve dhe raportit përfundimtar të KLSH-së nr.405/8, datë 23.09.2019”, është dërguar infomracion KLSH-së urdhër I kryetarit nr.849 , datë 07.10.2019 dhe plani i veprimit.



## V. ARRITJET KRYESORE:

Bashkia Shkodër ka plotësuar dhe dërguar në kohë pyetësonin e vetëvlerësimit të komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Raportit Vjetor të vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm, bazuar në pyetësonin të vetëvlerësimit për vitin 2018, dhe në Raportin Vjetor të vitit 2018, përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Sipas këtij raporti:

**Bashkia Shkodër rezulton në vend të I-rë rankimi sipas indikatorëve të performancës për vitin 2018.**

- 1. Vëmendje e veçantë gjatë vitit 2019 i është kushtuar monitorimit të detajuar dhe implementimit të regjistrave të saktë elektronikë të kapaciteteve fiskale, duke përfshirë gjithë territorin e bashkisë.**

Për këtë arsye pati mbështetje logjistike për strukturat e konstatimeve në vend të këtyre kapaciteteve, u ushtruan verifikime të vazhdueshme në të gjitha njësitë administrative, duke vijuar me formalizimin e të dhënave dhe digjitalizimin e tyre, me efekt arritjen e rezultate shumë të mira në pothuajse të gjithë zërat kryesore të të ardhurave.

**2. Gjatë katër viteve të fundit, Bashkia Shkodër ka vënë në zbatim disa sisteme informacioni të integruara me qëllim**

- ofrimin e shërbimeve elektronike për qytetarët,
- rritjen e aksesit për shërbime publike dhe administrative,
- uljen e kostove dhe përmirësimin e cilësisë,
- rritjen e të ardhurave vendore dhe menaxhimin e tyre,
- përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies duke ftuar qytetarët në vendimmarrje,
- identifikimin e shtresave sociale dhe shërbimeve që marrin, etj.

Ka përfunduar shtrirja e Sistemit të Integruar të Zyrave me Një Ndalesë (SIZIN) në të gjitha Njësitë Administrative dhe 5 Lagjet. Qytetarët dhe bizneset pavarësisht vendndodhjes së tyre mund të marrin shërbimet administrative në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër. Qytetarët përfitojnë 84 shërbime, prej të cilëve disa ofrohen pa pagese dhe disa të tjerë ofrohen kundrejt tarifave të miratuara në Paketën Fiskale.

Faturimi bëhet përmes Sistemit të Integruar të Taksave dhe Tarifave Vendore (SiTTV). Po ashtu edhe kontrolli i shlyerjes së detyrimeve vjetore për bizneset apo individët para përfitimit të shërbimeve administrative të ofruara përmes SiZIN, bëhet nga specialistët e drejtorisë së të Ardhurave të cilët aksesojnë SiTTV. Fluksi i kërkesave për shërbime

administrative në Zi1N në të gjithë bashkinë është rritur ndjeshëm nga dita në ditë. Po ashtu SiTTV është konsoliduar dhe funksional në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër, duke ofruar shërbime elektronike si:

- Dokumentin e Paktës Fiskale
- Qasjen e përdoruesve në aplikacion
- Regjistrime të Bizneseve
- Llogaritjen automatike të detyrimeve dhe gjenerimin e njoftimeve
- Gjenerimin automatik të faturave
- Regjistrimin e pagesave
- Faturimin e Individëve
- Verifikimin automatik për shlyerjen e detyrimeve vendore në SiZ1N dhe faturimin e shërbimeve me pagesë.

**3. SiTTV i integruar me SiZ1N, janë të ngritur në platformën Smartprocesses në web app dhe së fundmi janë azhornuar edhe në mobile app (iShkodra).**

Ky azhornim (upgrade) i jep mundësinë qytetarëve dhe bizneseve të aplikojnë nga shtëpia, smartphonei apo tableti i tyre për disa shërbime administrative që ofrohen përmes Z1N apo të llogarisin e të tërheqin faturat e detyrimeve vjetore vendore.

**4. Një tjetër iniciativë inovative e Bashkisë Shkodër është ajo e përfshirjes së qytetarëve në buxhetim përmes përdorimit të platformës online Transaprenca e Buxhetit, një instrument Open Data i realizuar për herë të parë dhe të vetme në Shqipëri.**

Ky instrument on-line informon publikun për të ardhurat vjetore të saj, shpenzimet dhe investimet, si dhe llogaritjen e taksave dhe tarifave vjetore të qytetarëve dhe bizneseve, si dhe i fton ato të shprehen on-line për kërkesa apo pakënaqësi të mundshme t'i drejtohen zyrave përkatëse përgjegjëse në bashki për zgjidhje. Në këtë portal bëhet publik çdo e dhënë mbi të gjitha të ardhurat në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër, çdo shpenzim apo investim të bërë sipas programeve buxhetore (vlera të parashikuara, vlera të realizuara, datë fillimi dhe mbarimi e shërbimit/investimit, operatori ekonomik fitues i procedurës së prokurimit, foto ilustruese pas përfundimit dhe dorëzimit të shërbimit apo investimit, mundësinë e marrjes së sugjerimeve nga qytetarët) për çdo vit kalendarik të detajuar sipas programeve buxhetore. Instrumenti ofron një modul tjetër të rëndësishëm për llogaritjen vjetore të taksave dhe tarifave për secilin prej nesh, i programuar në zbatim të dokumentit të Paketës Fiskale. Çdo e dhënë e bërë publike gjeolokalizohet në hartën e Bashkisë Shkodër e mbështetur mbi platformën Google Maps. Instrumenti azhrohent vazhdimisht nga të gjithë drejtuesit e programeve buxhetore në varësi të gjendjes (statusit) në të cilin ndodhen procedurat (*planifikuar = ikonë gjeolokalizuese e kuqe, në proces = ikonë gjeolokalizuese e verdhë, apo realizuar = ikonë gjeolokalizuese e gjelbër*), si dhe çdo

3-mujor raportohet në total me të ardhurat e mbledhura apo të transferuara dhe shpenzimet e realizuara.

Ky instrument është i ndërtuar mbi platformën Smartprocesse në web app dhe rezulton se vizitohet dhe monitorohet nga publiku përmes faqes zyrtare të internetit, tashmë është i azhurnuar dhe në mobile app (iShkodra) duke u mundësuar instalimi i tij në çdo smartphone apo tablet duke informuar qytetarët përmes mesazheve njoftuese të aplikacionit për informacion të publikuar/azhurnuar në kohë reale.

#### **5. Rreth dy vite më parë Bashkia Shkodër ka implementuar një sistem informacioni për Shërbimet Sociale.**

Qëllimi kryesor i implementimit të këtij sistemi është ofrimi i mundësisë për të populluar një bazë të dhënash të saktë me informacione mbi institucionet që ofrojnë shërbimeve sociale, si dhe mbi përfituesit që janë të regjistruar pranë këtyre institucioneve, në nivel vendor. Sistemi integron Drejtorinë e Shërbimeve Sociale në Bashki me Qendrat Komunitare në territorin e Bashkisë, duke ofruar mundësi për rritje të kontrollit mbi ushtrimin e aktivitetit të institucioneve si edhe rritje të transparencës mbi përfituesit e shërbimeve, në përputhje me ligjet në fuqi. Baza e të dhënave konsiston në identifikimin, regjistrimin dhe koordinimin e shërbimeve sociale që ofrohen në territor si dhe regjistrimin e përfituesve të të gjitha kategorive për të përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve në territorin administrativ. Baza e të dhënave përfshin modulet e mëposhtme:

- Ofruesit e shërbimeve sociale vendore, brenda territorit të Bashkisë
- Ofruesit e shërbimeve sociale vendore, jashtë territorit të Bashkisë
- Regjistri i përfituesve të shërbimeve sociale vendore
- Aplikues në process
- Puna në rrugë
- Udhëzues për përdorimin e database
- Baza Ligjore
- Raporte

Sistemi informatik është i ndërtuar mbi platformën web Smartprocesses, dhe si e tillë aksesohet lehtë nga të gjithë përdoruesit në bashkinë qendër apo në Qendrat Komunitare përmes shërbimit të internetit. Për të siguruar funksionimin dhe qendrueshmërinë e këtyre sistemeve, Bashkia Shkodër në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe rregulloret e implementimit të sistemeve të informacioneve të miratuara nga AKSHI, duhet të sigurojë mirëmbajtjen e liçensave të sistemit minimalisht për një periudhë 3-vjeçare.

#### **6. Bashkia Shkodër është institucioni i parë i qeverisjes vendore në Shqipëri që në respektim të parimit “qytetari në qendër” ka implementuar një model për ofrimin e Shërbimeve Administrative të Integruara të shtrirë tashmë në të gjithë territorin përmes hapjes Zyrrave të Integruara me Një Ndalesë (Zi1N) në**

**bashkinë Qendër, në të gjitha njësitë administrative dhe së fundmi është në proces shtrirja e sistemit në 5 Lagjet e qytetit.**

Në këto zyra ofrohen 83 shërbime administrative përmes një sistemi informatik të bazuar në një platformë web i cili menaxhon shërbimet e kërkuara nga qytetarët, pavarësisht se në cilën zyrë qytetari bën kërkesën, në formën e një rasti të mirëfilltë për procesim (case) duke e përcjellë atë elektronikisht me dokumentacionin përkatës bashkëlidhur, sipas një rrjedhe punë (workflow) të miratuar dhe të automatizuar. Në vitin 2019 rezultojnë 22206 kërkesa për shërbime të regjistruara dhe të ofruara përmes këtij sistemi informatik ndaj qytetarëve dhe bizneseve të Shkodrës. Implementimi i këtij projekti është mbështetur financiarisht nga Qeveria Zvicerrane dhe përkatësisht nga Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dlp). Mbështetja është realizuar në investime hardëare dhe softëare duke siguruar infrastrukturën e përshtatshme për qendrueshmërinë e tij në bashkinë Qendër, njësi administrative dhe lagje. Përmes marrëveshjes nr. 9376Prot datë 27.10.2015 të nënshkruar, dldp ka financuar blerje pajisjesh TIK të nevojshme për zyrën me një ndalesë të bashkisë Qendër dhe përmes marrëveshjes nr. 7975 Prot., datë 24.06.2016 të nënshkruar, DLDP ka financuar infrastrukturën fizike të ndërtimit të rrjetit të komunikimit elektronik (intranet) në 5 njësi administrative: Ana e Malit, Bërdicë, Guri i Zi, Postrinë dhe Rrethina. Informimi mbi këto shërbime dhe mbi procedurat e përfitimit të tyre vazhdimisht u është prezantuar qytetarëve në takime të tematikave të ndryshme, në dëgjesa publike, përmes afishimeve të bëra dhe fushatave informuese me fletëpalosje në të gjitha Zyrat me Një Ndalesë. Njëkohësisht vlerësojmë informimin e qytetarëve për këto shërbime, dhe mënyrën e përfitimeve të tyre përmes mediave vizive lokale si një njet tjetër i domosdoshëm komunikimi qytetar-qeverisje vendore.

**7. Bashkia Shkodër zotëron faqen zyrtare interneti nën domain-in [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al). Kjo faqe është 24/7 online dhe aktualisht është një faqe e nivelit të III- të në përputhje me rregulloren e AKSHI-t për faqet zyrtare në administratën publike.**

Faqja është e ndërtuar mbi platformën web easyweb 2.0, një sistem i menaxhueshëm nga përdoruesit e bashkisë në nivel përmbajtjeje. Ofruesi i këtij shërbimi është përgjegjës për host-imin, mirëmbajtjen teknike dhe ofrimin e shërbimit të adresave e-mail të stafit nën domain-in zyrtar.

Në faqe janë të integruar disa module që mundësojnë pjesëmarrjen e qytetarëve dhe demokracinë vendore në kuadër të mirëqeverisjes elektronike vendore.

- Moduli i Librarisë Ligjore i implementuar dhe i integruar në faqe, bën të mundur që bashkia të ndajë me qytetarët të gjithë projekt-vendimet dhe vendimet e Këshillit të Bashkisë përmes një moduli të menaxhueshëm në ëeb nga Sekretaria e Këshillit të Bashkisë.

- Moduli e-Pjesëmarrje i implementuar dhe i integruar në faqe, mundëson krijimin e vazhdueshëm të sondazheve me tematika të ndryshme dhe marrjen e mendimeve nga qytetari, lehtësisht i menaxhueshëm nga punonjësit e bashkisë.
- Moduli i SiZIN, i integruar në faqen web, bën të mundur gjurmimin e kërkesave për shërbim të qytetarëve (tregon se në cilin status të aplikimit ndodhen shërbimet) që aplikohen në Zyrën e Integruar me Një Ndalesë në Bashkinë Qendër apo Njësitë Administrative, direkt nga portali zyrtar on-line.
- Shkarkimi i formularëve on-line,
- Informacioni i detajuar i regjistrit të kërkesave,
- Raportet e auditimit,
- Raportet financiare,
- Buxheti dhe realizimi i tij,
- Paketa fiskale,
- Transparenca e buxhetit,
- Raportimi online,
- Forumi online, etj.

Në kuadër të programit të transparencës këto janë një tjetër mjet i përfshirjes së qytetarit përmes këtij portaliweb.

**Aktualisht faqja zyrtare e inernetit e Bashkisë Shkodër është e një niveli të lartë informimi dhe përfshirëse e qytetarëve, e vlerësuar me çmimin e parë në vitin 2017 në kuadër të transparencës për zbatimin e të drejtës për informim ndër 61 bashkitë e vendit tone.**

Bashkia Shkodër administron një territor të gjerë, duke përfshirë edhe territorin e disa njësisve administrative (ish komunave) me një shtrirje të madhe dhe diversitet të madh. Në funksion të ofrimit të shërbimeve administrative për qytetarët dhe bizneset Bashkia Shkodër ka vënë në funksion një sistem të zyrave me një ndalesë, i shtrirë në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër. Ndonëse nëpërmjet vënies në zbatim të sistemit të zyrave të integruara me një ndalesë, sfida imediate e garantimit të ofrimit të shërbimeve administrative në njësitë administrative konsiderohet e kapërcyer, ka sfida të tjera që kanë të bëjnë me:

*“Modernizimin e qytetit dhe shërbimeve për qytetarët, përmirësimin të eficiencës së punës, rritjen e transparencës dhe nxitjen e zhvillimit të integruar”.*

**Kujdes të veçantë gjatë vitit 2019 ju kushtua përmirësimin të mëtejshëm të sistemeve të kompjuterizuara, sistemit të integruar të Taksave dhe Tarifave, detajimit të**

**raporteve, emetimit të statistikave, saktësimin dhe detajimit të të dhënave për bizneset, etj.**

Kështu u hapën module të reja për digjitalizimin on-line të akt-kontrolleve të mbajtura në terren, u mundësua hedhja on-line në sistemin e taksave të gjobave të Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit dhe Policisë Bashkiake, u mundësua llogaritja automatike e kamat-vonesave, u mundësua llogaritja e menjëhershme dhe emetimi i akt-marrëveshjeve pranë ZIN për subjektet shfytëzuese të hapsirave publike, parkingjeve, ambulanteve etj.

Raporte nga organizatat tjera Kombetare dhe Nderkombetore:

1. Qendra Res Publica "Për të drejtën e Informimit, viti 2019, Veshtrim krahasues nder vite"; kemi marrë çmimin e pare per Transparençen .

<http://www.respublica.al/category/ekonomi?page=7>

2. Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit Janar 2020, eshte publikuar Raporti i Financave Publike Vendore per (9 -M 2019)., [www.portavendore.al](http://www.portavendore.al),

**Bashkëngjitur këtij relacioni janë vendosur në CD i gjithë dokumentacioni i KLSH-së dhe raportet e publikuara.**



## VI. Sponsorizimet per vitin 2019

Për vitin 2019 Bashkia Shkodër ka marre sponsorizime ne natyre në shumën **23,202,384 leke** si më poshtë vijon:

Donatori	Objekti	Vlera Lekë
Consulting and Development partners Partnere ne Projektin" Rini e Fuqizuar, e Ardhme e Qendrueshme YES Future"	Paisje per inkubatorin e biznesit „ATELIE“	1,339,800
UNDP Tirane	Dhurim paisje zyre te perdorura nga zyra lokale ne Shkodër pas mbylljes se projektit	354,765
UNDP Tirane	ESERE Project per Kopshtin Guerile Paisje mobilimi	2,231,400
World Vision Albania	Paisje te perdorura per Qendren Komunitare Multifunksionale" Per Familjen " ne Njesine Administrative Rrethina "	220702
World Vision Albania	Paisje dhe libra per Qendren Komunitare Multifunksionale" Per Familjen " ne Njesine Administrative Rrethina "	114165
<b>Totali</b>		<b>4,260,832</b>

### Donacionet/sponsorizimet totale ne leke

**1,330,261**

Sponsorizime nga organizata jo qeveritare ( UNDP)

999,570

Sponsorizime nga organizata jo qeveritare ( Observatori per te Drejtat e femijeve

dhe te rinjve

88,000

Sponsorizime nga organizata jo qeveritare ( proj. DEAR Drejtorise se Sherbimeve Sociale,mbi projektin DEAR" MODELIMI I QYTETEVE TE DREJTA: )

242,691



## VII. Treguesit financiarë që publikohen.


Treguesit financiarë		2019
1	Shpenzimet e përgjithshme / Te ardhurat e përgjithshme	79.4%
2	Taksat dhe tarifat lokale / Të ardhurat e përgjithshme	15.2%
3	Te ardhurat nga burimet e veta/te ardhurat e përgjithshme	18.8%
4	Të ardhurave faktike të mbledhura, kundrejt planit të periudhës dhe planit vjetor të të ardhurave	99.7%
4/1	Të ardhurave faktike të mbledhura, nga dy kategoritë kryesore të taksapaguesve, personave fizikë e juridikë (familjarë dhe subjekteve juridike)/ kundrejt planit vjetor të të ardhurave	94.08%
5	Shpenzimet kapitale/Shpenzimet e përgjithshme	22.03%
6	Shpenzimet e personelit /Shpenzimet e përgjithshme	21.87%
7	Shpenzimet korente /Totalit te shpenzimeve	77.97%
8	Huamarrjes afatgjatë ndaj totalit te te ardhurave	Nuk ka
9	Huamarrjes afatgjatë ndaj të ardhurave të veta	Nuk ka
10	Detyrimeve financiare të papaguara në kohë ndaj të tretëve ndaj të ardhurave të përgjithshme;	1.4 %
11	Detyrimeve tatimore të paarkëtuara në kohë ndaj të ardhurave tatimore;	108.6 %
12	Shpenzimeve për partneritetet publike private ndaj shpenzimeve të përgjithshme;	Nuk ka
13	Shpenzimeve për politikat e kujdesit shoqëror ndaj shpenzimeve të përgjithshme;	31.4%
14	Shpenzimeve për politikat që mbështesin barazinë gjinore ndaj shpenzimeve të përgjithshme.	39.1%

Sekretar i Këshillit



Denis Lesha

KRYETARE



Briseta KADIJA